

Gospaven. Shpesh shkonte zyrtarisht në Kosovë, herën e fundit në verën e vitit 1998. Në datën **22.09.1998**, së bashku me dy kolegë nga forcat policore, ka qenë duke e bërë patrullimin në fshatin **Polluzhë/Poluža**. Lëviznin ndaras. Kur dy anëtarë të patrullës policore i dëgjuan të shëna që vinin nga drejtimi i Branislavit, shkuan menjëherë atje. E gjetën trupin e tij të pajetë, të shtrirë në tokë. Ishte qëlluar për vdekje me një rafal plumbash në stomak dhe në gjoks. Familjarët e kanë varrosur Branislavin në varrezat e Dolevacit më 24.09.1998.

Burimet: deklarata D.M, FDH-25565; SMIP, *Teroristički...*, III, 513, 939; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 41; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Ivan (Dragiša) Petković

(27.03.1978, serb nga Çitlluku, komuna e Krushevcit, moler, pjesëtar i UJ-së)

Ivani ka nisur nga puna që prej moshës 12 vjeçare. Shkonte me motrën e vetë në Mal të Zi që të merrte pjesë në vjeljet e vreshtave. Madje, përpara shkuarjes në shërbimin ushtarak, punonte edhe si moler. Në muajin qershor të vitit 1998, e ftuan për kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak. Atje, ai e vijoi trajnimin për tankist. Gati tre muaj pas përfundimit të trajnimit, e dërguan në Prishtinë/Priština. Në datën **22.09.1998**, njësi i tij u nis për një aksion të pastrimit të terrenit në zonën e bjeshkës së *Çiçavicës/Čičavica*. Në fshatin e **Çikatovës së Vjeter/Staro Čikatovo**, pjesëtarë të UÇK-së e kanë qëlluar tankun e Ivanit me minahedhës krahu. Predha e minahedhësit ka depërtuar nëpër trupin e tankut dhe e ka plagosur rëndë Ivanin në qafë. Ka ndërruar jetë në helikopterë me të cilin e transportonin në spital. Ivanin e kanë varrosur në varrezat e Çitllukut më 24.09.1998.

Burimet: deklarata M.N.P, FDH-16282; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 52; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 725, 980; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Bahtije (Sahit) Gashi

(1918, shqiptare nga Vrboci/Vrbovac, komuna e Glogocit/Glogovac, dy fëmijë)

Bahtija e moshëthyer me familje jetonin në **Vrboc/Vrbovac**. Kur, më **22.09.1998**, forcat serbe filluan t'i afroreshin fshatit, nipi i Bahtijes, Xhemaili, e ka çuar me makinë gjyshen e vet në një rrugicë në hyrje të pyllit *Nerllaz*, përderisa anëtarë të tjerë të familjes, së bashku me kushëririn e tyre Ramadan Gashin u larguan më herët me traktor. Nga ora 16:00 të së njëjtës ditë, Xhemaili vërejti se forcat serbe me autoblanda po lëviznin drejt tyre. Deshi me gjyshen Bahtijen të arratiseshin nga vendi ku ishin duke pushuar, por ushtarët serbë hapën zjarr dhe e qëlluan Bahtijen në kokë. Ndërroi jetë në vend. Xhemaili ia arriti të zhdukej në pyll. Të nesërmen, ai u kthye në vendin e ngjarjes që ta merrte trupin e pajetë të gjyshes. E ka varrosur gjyshen në varrezat e fshatit Vrboc/Vrbovac më 24.09.1998.

Burimi: deklarata X.G, FDH-14903.

Sheqir (Hajdin) Krasniqi

(1.06.1981, shqiptar nga Gllanasella/Gladno Selo, komuna e Glogocit/Glogovac, nxënës)

Sheqiri shkonte në shkollën e mesme teknike. Në datën **22.09.1998**, kur forcat serbe e nisën sulmin mbi Gllanasellën/Gladno Selo dhe fshatrat përreth, familja e Sheqirit, së bashku me fshatarë të tjerë, u strehua në vendin e quajtur *Fusha e Mollës/Jabukovo polje*, në afërsi të fshatit **Vrboc/Vrbovac**. Sheqiri ka mbetur në fshat, së bashku me të afërmin Avdiun. Thanë se do të shkonin më vonë te *Fusha e Mollës/Jabukovo polje*. Pas pesë ditësh, vëllai i Sheqirit, Ramadani, të cilin gjatë kësaj kohe policia e mbante të mbyllur në Stacionin Policor në Glogoc/Glogovac, u kthye në fshat. U takua me Avdiun, i cili i tha se ai dhe Sheqiri, në datën e 22.09.1998, ishin nisur drejt *Fushës së Mollës/Jabukovo polje* dhe së në rrugë e sipër u ndeshën me policinë, e cila menjëherë hapi zjarr drejt tyre. Sheqiri iku në njërën, ndërsa Avdiu në anën tjetër. Pas tërheqjes së forcave serbe nga rajoni [25.09.1999], Avdiu dhe disa ushtarë të UÇK-së u kthyen në vendin ku ai ishte ndarë nga Sheqiri dhe aty e gjetën trupin e tij. Sheqirin e kishin qëlluar për vdekje me një plumb në kokë. Po atë ditë,